



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeni/Prodato Received/Delivery	25.08.2023	3	viti god Year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Bi Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHOK	5817	2023	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.955/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.955/2023 të datës 13.07.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër KA.nr.21/2023 të datës 26.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.08.2023, mori këtë.

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.955/2023 e datës 13.07.2023 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 15.02.2023 ka shpall konkursin e jashtëm me numër Nr.01/2023 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media" në Gjykatën Themelore të Mitrovicës në të cilin konkurs kanë aplikuar shtatë (7) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi, ku sipas Raportit të datës 01.03.2023 Komisioni Përzgjedhës ka përgatitur listën e ngushtë, nga rrjedhë se sipas këtij raporti pesë (5) kandidatë (në mesin e tyre edhe ankuesi) kanë plotësuar kushtet e konkursit ndërsa dy (2) kandidat nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesi është përfshirë në fazat e procedurës konkretisht listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e cekur më lartë sipas formularit Form.MAP-SHCK-10 të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi është renditur i dyti me pikë me gjithsejtë 382.5, ndërsa sipas Njoftimit me numër Nr.03/701 për kandidatin e suksesshëm të datës 12.05.2023, ankuesi nuk rezulton të jetë kandidat i suksesshëm.

Ankuesi kundër njoftimit me numër Nr.03/701 për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023, më datë 01.06.2023 ka parashtruar ankesë Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 26.06.2023 ka nxjerr vendim me numër KA.nr.21/2023 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare me numër Nr.03/701 të datës 12.05.2023.

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.03/601 të datës 12.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë më datë 13.07.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë e cila është protokolluar me numër 5183/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 27.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 5183/2023 të datës 13.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër nr.01/826 të datës 01.06.2023 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Diplomë me numër Nr.2669 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës më datë 21.12.2016; Vendimin me numër KA.nr.21/2023 i datës 26.06.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 27.07.2023; Fletëkthesë e datës 04.07.2023; Raportet me numër Form.MAP-SHCK-08a i datës 04.05.2023; Testi me shkrim; Udhëzues për testin me shkrim i datës 04.05.2023; Kërkesë për punësim e datës 22.02.2023; Certifikatë mbi denimet penale me numër Nr.ser.BA623DB196DE432 e datës 21.02.2023; Kopje e letërnjoftimit për M.V; Akt Emërim me numër reference: GJA.nr.207/2019 i datës 20.08.2019; Vërtetim me numër GJA.57/2023 i datës 22.02.2023; Vërtetim me numër DBNJ/Nr.163/2019 i datës 08.08.2019; Vërtetim me numër 07/2130/2353/2 i datës 21.11.2023; Shkresë e datës 24.10.2016; Shkresë e datës 19.08.2009; Shkresë e datës 19.08.2009; Shkresë e datës 27.08.2009; Vërtetim i datës 30.11.2000; Shkresë e datës 15.09.2009; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare me numër 03/701 e datës 12.05.2023; Propozimi për emërimin e kandidatit të rekomanduar e datës 12.05.2023; Vendim me numër 03/449 i datës 24.03.2023; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues i datës 10.05.2023; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja

përfundimtare e kandidatëve; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Deklaratat për mosekzistim të konfliktit të interesave të anëtarëve të komisionit e datës 06.04.2023; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 22.02.2023; Konkursi i jashtëm me numër 01/2023 i datës 15.02.2023; Vlerësimet e anëtarëve të komisionit për H.H prej 1-5 faqe; Testi me shkrim i H.H; Udhëzues për testin me shkrim për H.H e datës 04.05.2023; Kërkesa për punësim e H.H e datës 24.02.2023; Kopja e letërnjoftimit të H.H; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPoHE Kolegji AAB për H.H me numër 579/2022 e datës 28.04.2022; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPoHE Kolegji AAB për H.H me numër 541/10 e datës 13.09.2010; Kontratë pune për kohë të caktuar e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor me numër 03/1793 e datës 22.09.2022; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 01.01.2022; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 31.12.2021; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 14.06.2021; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 22.12.2020; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 30.06.2020; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 26.12.2019; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 26.06.2019; Kontratë e Shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 31.12.2018; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër 074/11 e datës 07.07.2011; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër 1288/2012 e datës 18.12.2012; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 3068/2014 e datës 30.01.2014; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 3589/2014 e datës 15.09.2014; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 1922/2015 e datës 10.12.2015; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref. 2342/2018 e datës 11.10.2018; Kontratë pune e lëshuar nga Kolegji AAB me numër ref.2699/2017 e datës 22.11.2017; Vërtetim i lëshuar nga Av. Zef Berisha e datës 21.08.2010; Certifikatë e lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë 04 Nr.221 e datës 14.08.2009; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Trajnimeve dhe Karrierës i datës 23.12.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.nr.21/2023 të datës 26.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon se procedura e përzgjedhjes së kandidatit fitues nuk është bërë sipas rregullave në fuqi për pozitën e punës *"Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media"*.

Nga administrimi shkresave të parashtruara nga kandidatët për praninë në shërbimin civil, ka gjetur se për të njëjtën procedurë të rekrutimit dhe për pozitën e njëjtë *"Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media"* të zhvilluar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është evidentuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.07.2023 ka pranuar ankesë me numër të protokollit 5300/2023 nga një kandidate në procedurë respektivisht kandidatja me iniciale F.A, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me qëllim të shqyrtimit të ankesës së saj me datë 24.08.2023

ka nxjerr vendim me numër A.nr.1009/2023, përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e ankueses F.A dhe anuluar njoftimin me numër Nr.03/701 për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023, listën e ngushtë të kandidatëve duke përfshirë rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe raportin final të rekomandimit nga Komisioni Përzgjedhës i datës 10.05.2023, ndërsa lëndën e ka kthyer në *“Ri-shqyrtim duke e obliguar Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të ri-zhvilloj procedurën e rekrutimit për “Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media”*” në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.

Andaj në rrethanat e rastit konkret lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit sikurse edhe me objektin e shqyrtimit të ankesës së tij, gjegjësisht konkursin e zhvilluar si dhe njoftimin me numër Nr.03/701 për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023 për pozitën e punës *“Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media”*, Kolegji i Këshillit konstaton se është vendosur sipas Vendimit me numër A.nr.1009/2023, gjegjësisht aktet e kontestuara nga pala ankuese i ka anuluar, ndërsa Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka detyruar ta zhvillojë përsëri procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër 01/2023 për pozitën *“Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media”* në Gjykatën Themelore të Mitrovicës nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë deri në fazën e përfundimit për arsyeje se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku për rrjedhojë kjo vendimmarrje ka efekte juridike edhe ndaj ankuesit pasi që ka qenë kandidat në procedurë të rekrutimit.

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas rrethanave të krijuara juridike e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse sipas Vendimit me numër A.nr.1009/2023 të datës 24.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë anuluar të gjitha veprimet e kësaj procedure deri në shpalljen e konkursit, konsiderohet që ankesa e ankuesit nuk ka objekt shqyrtimi dhe mbi këtë bazë objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,

Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.955/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

